



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr 4820 Prot

Vlorë, më 24.042023

Lënda: Njoftim për mbledhjen e këshillit të bashkisë, datë 28 prill 2023.

ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË VLORË

PREFEKTIT TË QARKUT VLORË

Ju njoftoj se, **ditën e premte , datë 28.04.2023, ora 10:00**, në pallatin e kulturës “Labëria” do të zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë Vlorë, e thirrur nga Kryetarja e këshillit, në bazë të ligjit nr. 139/2015, neni 53 pika 4, me këtë

REND DITE :

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së këshillit të bashkisë , datë 31.03.2023 .
2. Miratimi i projektvendimit “ Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë për muajin mars 2023”.
3. Miratimi i projektvendimit “ Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin mars 2023”.
4. Miratimi i projektvendimit “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së znj. Tefta Selimllari në datën 26.12.2022 dhe, shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë “.

5.Miratimi i projektvendimit “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së zonjës Engjëllushe Halili në datën 23.01.2023 dhe, shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”

Konferenca e Kryetarëve, do të zhvillojë mbledhjen, **ditën e enjte**, datë **27.04.2023**, në mjediset e bashkisë Vlorë, në orën **09:00**.

Komisionet e përhershme do të mblidhen po në mjediset e bashkisë Vlorë, si më poshtë :

Komisioni juridik, i rendit dhe i sigurisë vendore publike do të mblidhet **ditën e enjte** , datë **27.04.2023**, ora 09.30.

Komisioni i ekonomisë, financave dhe privatizimeve, do të mblidhet **ditën e enjte**, datë **27.04.2023**, ora 10.00.

KRYETARE

Migena Balla

